



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 gusht 2024  
Nr. Ref.: RK 2498/24

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI128/23

Parashtrues

**Ilirjana Shabanaj**

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,  
[Rev.nr.295/2022], të 27 shkurtit 2023

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është parashtruar nga Ilirjana Shabanaj (në tekstin e mëtejme: Parashtruesja e kërkesës), e cila përfaqësohet nga Hajzer Salihu, avokat nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev.nr.295/2022], e 27 shkurtit 2023, (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i kontestuar) të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 30 mars 2023.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të saj, të garantuara me nenet: 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejme: Kushtetuta], dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [në tekstin e mëtejme: KEDNJ].

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 12 qershor 2023, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Gjykata).
7. Më 15 qershor 2023, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin Nr.GJR.KI128/23, caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare raportuese dhe me Vendimin Nr.KSH.KI128/23, caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi - Peci dhe Enver Peci (anëtarë).
8. Më 22 qershor 2023, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, një kopje e kërkesës së parashtrueses iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
10. Më 29 prill 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Më 15 qershor 2011, u nënshkrua kontrata e punës ndërmjet parashtrueses së kërkesës dhe Bankës "ProCredit", me adresë kryesore në Prishtinë [në tekstin e mëtejme: Punëdhënësi]. Sipas kësaj kontrate, parashtruesja e kërkesës e mbante pozitën e punës: Këshilltar për Klientë për Biznese të Vogla dhe Analist për Kredi të Vogla. Parashtruesja kishte marrëdhënie pune me punëdhënësin nga viti 2006.

12. Më 10 shtator 2012, Bordi i Drejtorëve i Punëdhënësit miratoi propozimin e Bordit Menaxhues për ristrukturim, duke u bazuar në ndryshimet ekonomike, teknologjike, organizative dhe strukturale të punëdhënësit. Ndryshimet parashihnin, ndër të tjera, rritjen e produktivitetit të përgjithshëm të stafit dhe pikave të shërbimit.
13. Më 20 shkurt 2014, Bordi Menaxhues i Punëdhënësit mori vendim për riorganizimin e pikave të shërbimit, përkatësisht u shua pozita e zyrtarit për shërbime bankare.
14. Më 5 maj 2014, punëdhënësi mori vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me parashtruesen e kërkesës për shkak të riorganizimit të shërbimeve dhe pamundësisë së transferimit në një vend tjetër të punës. Vendimi parashihte që ndërprerja e marrëdhënies së punës fillonte nga 20 qershori 2014. Sipas arsytimit, me shuarjen e pozitës së parashtrueses së kërkesës, nuk ishte më nevoja për shërbimet e saj. Punëdhënësi theksoi se kishte konsideruar mundësinë e transferimit të parashtrueses së kërkesës në një pozitë tjetër të përshtatshme për kualifikimin e saj, megjithatë një gjë e tillë nuk ishte e mundur.
15. Më 6 maj 2014, punëdhënësi e njoftoi parashtruesen e kërkesës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të riorganizimit të punës.
16. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesja e kërkesës dorëzoi ankesë tek punëdhënësi, kundër vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Punëdhënësi nuk kishte dhënë përgjigje në lidhje me ankesën e parashtruar.
17. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesë në Inspektoratin e Punës, me pretendimin se vendi i saj i punës nuk ishte shuar nga punëdhënësi por vetëm i ishte ndërruar emërtimi. Ajo kërkoi nga Inspektorati i Punës të ndërmerre të gjitha veprimet juridike për mbrojtjen e të drejtave të saj nga marrëdhënia e punës.
18. Më 21 korrik 2014, Inspektorati i Punës nëpërmjet Vendimit [01 Nr.08-41/2014], miratoi kërkesën e parashtrueses së kërkesës dhe obligoi punëdhënësin që të ndërmerre disa veprime për eliminimin e parregullsive të konstatuara nga inspektorët e punës, përkatësisht të rishqyrtonte vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe të përcaktonte obligimet që dalin nga neni 70 i Ligjit të Punës.
19. Në një datë të paspecifikuar, punëdhënësi parashtrroi ankesë kundër Vendimit të Inspektoratit të Punës, në shkallën e dytë të këtij institucioni, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe propozoi anulimin e vendimit të shkallës së parë.
20. Më 23 shtator 2014, Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, si shkallë e dytë, nëpërmjet Vendimit [80/2014], refuzoi ankesën e punëdhënësit dhe vërtetoi vendimin e shkallës së parë, duke arsyetuar se punëdhënësi bëri *“shkelje të dispozitave ligjore të ligjit të punës, sepse vendimi i bordit të bankës të datës 20.02.2014 për shuarjen e vendit të punës pozita e zyrtarit për shërbime bankare nuk ka të bëjë fare me pozitën këshilltarë për klientë për biznese të vogla dhe analist për kredi të vogla për të cilin vend pune kërkesja ka lidhur Kontratë pune”*. Po ashtu, punëdhënësi *“nuk e ka precizuar me aktet e veta se cilat vende pune për shkaqe ekonomike, teknike dhe organizative do të shuhen dhe cilat masa do të ndermirën për ty mundësuar transferimin e punonjësve në një vend tjetër të punës ose ta trajnoj a ta kualifikoj atë për të kryer punën ose ndonjë punë tjetër”*, dhe *“nuk i ka dhënë udhëzime juridike palës dhe është marrë nga organi jo kompetent”*.
21. Më 14 qershor 2016, parashtruesja e kërkesës dorëzoi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë [në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore], nëpërmjet së cilës kërkonte

anulimin e vendimit të punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Së pari, parashtruesja pretendonte se punëdhënësi nuk e kishte arsyetuar faktin që ishte shuar pozita e saj e punës. Sipas saj, vetëm ishte ndryshuar emërtimi i pozitës dhe se nuk bëhej fjalë për shuarje. Së dyti, parashtruesja argumentonte se vendimi nuk ishte marrë në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit të Punës, nenit 70 dhe 71, në lidhje me obligimin e punëdhënësit për të paralajmëruar paraprakisht punëtorin për largimin nga puna. Së treti, parashtruesja pretendonte që punëdhënësi nuk kishte zbatuar asnjë procedurë të vlerësimit për largimin e saj nga puna. Një vendim i tillë, shkruante ajo, ishte bazuar në konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit material.

22. Më 21 mars 2019, Gjykata Themelore nëpërmjet Aktgjykimit [C.nr.1732/2014], vendosi si në vijim: (i) aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës; (ii) anuloi si të kundërligjshëm vendimin e punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës; (iii) Punëdhënësi u detyrua që t'ia paguante parashtrueses së kërkesës të gjitha pagat të cilat do t'i kishte realizuar nga momenti i largimit nga puna, përfshirë edhe pagesën e trustit pensional, tatimin në pagë dhe kamatën, në vlerë të tërësishme prej 43.283.33 euro, dhe që të rikthente në vendin e punës apo në një pozitë tjetër të përshtatshme parashtruesen e kërkesës; (iv) detyroi punëdhënësin që t'ia kompensonte parashtrueses së kërkesës shpenzimet e procedurës kontestimore në vlerë prej 1.490.00 euro. Gjykata Themelore konstatoi se *“vendimi nr. 14/488 të datës 05.05.2014 me të cilën paditëses i është ndërprerë marrëdhënia e punës përfundimisht me datë 20.06.2014, është vendim i kundërligjshëm dhe pa mbështetje në prova dhe fakte”*. Gjykata Themelore arsyetoi se *“paditësja nuk ishte paralajmëruar për qëllimin se do të ndërpritej marrëdhënia e punës ashtu siç kërkohet me dispozitat e cekura ligjore. Kjo argumentohet me faktin se paditëses njoftoi për takim me zyrtarët e të paditurës i është dorëzuar me datë 05.04.2014 takime ishte caktuar për datën 06.05.2014, ndërsa edhe vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ishte marrë të njëjtë ditë kur paditëses i ishte dorëzuar njoftimi për takim që është në kundërshtim me nenin e cekur më lart”*. Gjykata Themelore vlerësoi se *“arsyet të cilat i ka cekur e paditura se paditëses i është ndërprerë marrëdhënia e punës për arsye ekonomike, teknike dhe organizative nuk janë argumentuar se për cilën situatë ligjore bëhet fjalë në rastin konkret”*, dhe që *“shuarjen e vendit të punës nuk e parasheh as vendimi i Bordit Menaxhues i të paditurës i datës 20 shkurt 2014 e as memoja e datës 27.01.2014”*.
23. Në një datë të paspecifikuar, punëdhënësi parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotës të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material, dhe kërkoi anulimin e këtij Aktgjykimi dhe kthimin e çështjes në rivendosje.
24. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, vetëm në lidhje me caktimin e lartësisë së kamatës.
25. Më 26 janar 2022, Gjykata e Apelit nëpërmjet Aktgjykimit [AC.nr.6056/2022], vendosi si në vijim: (i) vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në lidhje me anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës; (ii) anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, në lidhje me kthimin e parashtrueses së kërkesës në vendin e punës dhe kompensimin e pagave, trustit pensional dhe kamatës; (iii) anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në lidhje me pagesën e shpenzimeve të procedurës kontestimore nga ana e punëdhënësit. Gjykata e Apelit theksoi se *“vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ishte marrë të njëjtën ditë kur paditëses i ishte dorëzuar njoftimi për takim me qëllim të diskutimit të arsyeve për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, gjë që është në kundërshtim me kërkesat ligjore që rrjedhin nga dispozita e cekur e Ligjit të Punës”*. Gjykata e Apelit vlerësoi se *“me të drejtë ka konstatuar gjykata e shkallës së parë se e paditura nuk ka ofruar prova të mjaftueshme me të cilat do të*

*provohej fakti se me të vërtetë për arsye të futjes në përdorim të teknologjisë është dashur të shuhet vendi i punës i paditëses dhe se e njëjta konform dispozitës së cekur më lart, të ketë bërë përpjekje që nëse është e përshtatshme për punëdhënësin që ta transferojë të punësuarin në një vend pune tjetër, ta trajtojë a ta kualifikojë atë për ta kryer punën ose ndonjë punë tjetër”. Gjykata e Apelit vuri në pah se “gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë sqarime të nevojshme se në rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës paditëses a ka pasur diskriminim nga e paditura, ashtu siç është e përcaktuar me nenin 80, lidhur me nenin 5 të Ligjit të Punës”.*

26. Në një datë të paspecifikuar, punëdhënësi parashtrori revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
27. Më 22 shkurt 2023, Gjykata Supreme nëpërmjet Aktgjykimit [Rev.nr.295/2022], refuzoi në tërësi kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës dhe anuloi Aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit, në pjesët ku i kishin dhënë të drejtë parashtrueses së kërkesës. Gjykata Supreme arsyetoi se “nga gjendja faktike e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, shihet qartë se e paditura ka qenë e detyruar të bënë ndërprerjen e marrëdhënies së punës për paditësen, për faktin se ka bërë ristrukturimin apo organizimin e ri të punës, për shkak të mbylljes së pozitës ku ka punuar paditësja”. Gjykata Supreme mori parasysh “se e paditura ka shqyrtuar mundësinë e transferimit apo sistemimin e paditëses në një vend tjetër të punës, por për shkak të pamundësisë së transferimit, për shkak të numrit të madh të punëtorëve, dhe faktit se në të gjitha njësitë ka pasur zvogëlim të numrit të punëtorëve, ka qenë e detyruar në ndërprerjen e marrëdhënies së punës të paditëses”. Prandaj, Gjykata Supreme theksoi se “në rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës të paditëses i ka respektuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore të lartcekura, pasi që më datë 05.05.2014, e njëjta e ka ftuar paditësen paraprakisht për riorganizimin dhe ristrukturimin e sistemit të punës, dhe konkretisht mbylljen e pozitës në të cilën ka punuar paditësja dhe njoftimin e pamundësisë së transferimit në një pozitë tjetër të punës, për shkak të numrit të madh të punëtorëve edhe në njësitë e tjera”. Gjykata Supreme vlerësoi se “edhe pse paditësja në të njëjtë ditë që është ftuar për njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, i është dorëzuar vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, vendimi i të paditurës ka qenë me efekt prej datës 20.06.2014, që do të thotë se është përmbushur afati i njoftimit paraprak prej 30 ditësh”.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

28. Parashtruesja e kërkesës pretendon se: “Konsiderojmë se paditësja nuk ishte paralajmëruar për qëllimin se do të ndërpritej marrëdhënia e punës siç kërkohet me dispozitën e cekur ligjore. Kjo argumentohet me faktin se paditëses njoftim për takim me zyrtarët e të paditurës i është dorëzuar me datë 05.05.2014, takimi ishte caktuar për datën 06.05.2014, ndërsa edhe vendimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës mban datën e dorëzimit të njoftimit 05.05.2014. Pra vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ishte nxjerrë të njëjtë ditë kur paditëses i ishte dorëzuar njoftimi për takim... Fryma e normës dikton që takimi i punëdhënësit me të punësuarin detyrimisht duhet të mbahet para se të jepet vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe se në atë takim punëdhënësi duhet të shpjegojë se cilat janë arsyet dhe shkaqet që kanë sjellë deri te qëndrimi për ta ndërprerë marrëdhënien e punës me të punësuarin. Kjo pastaj supozohet që ti jep të punësuarit hapësirë që ti kundërshtoj argumentet e punëdhënësit, dhe të bëjë përpjekje që ta ndryshoj qëllimin e tij”.
29. Parashtruesja e kërkesës pretendon se: “Gjithashtu avancimet teknologjike në të cilat është thirrur e paditura, nuk kanë qenë me ndikim në shuarjen e vendit të punës së

paditëses, sepse kryeja e punëve ka qenë caktuar ajo, analizimi i dokumenteve të klientëve-kërkesave për kredi të vogla, nuk mund të zëvendësohen me futjen e teknologjisë. E nëse për shkak të futjes së teknologjisë së re janë shuar vende pune, atëherë del të jenë shuar ato vende të punës ku teknologjia e zëvendëson punën e njeriut, e kjo nuk vlen për vendin e punës në të cilin ka punuar paditësja, kurse po ashtu e paditura nuk ka bërë përpjekje që ta sistemoj paditësen në ndonjë vend tjetër pune...”

30. Parashtruesja e kërkesës pretendon se: “Po ashtu e paditura kur kishte ndërprerë marrëdhënien e punës se parashtrueses së kësaj kërkesë, kishte vepruar edhe në kundërshtim me nenin 53 të Ligjit të Punës, i cili përcakton se “Gjatë kohës së shtatzënisë, pushimit të lehonisë dhe mungesës në punë për shkak të përkujdesjes së veçantë ndaj fëmijës, punëdhënësi nuk mund t’ia shkëpusë kontratën të punësuarit dhe t’ia ndërrojë vendin e punës”, pasi që nuk kishte marrë për bazë fare faktin që znj. Shabani kishte qenë në pushim të lehonisë, për shkak se me datë 01.07.2013 kishte sjellë në jetë djalin e saj E.V, e i cili lindjen e kishte me probleme për çfarë edhe ishte transferuar nga Spitali Bahceci ku kishte kryer lindjen, në QKUK Prishtinë për trajtim të foshnjës, i cili kishte zgjatur deri me dt. 10.08.2013. Po të merrej për bazë ky fakt, punëdhënësi nuk do duhej që të ndërmernte veprime që e dërgojnë në shkeljen e kësaj të drejte, e cila është e sanksionuar edhe përmes dispozitave të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, e cila gjen zbatim të drejtpërdrejtë edhe në vendin tonë, ashtu siç parashihet me nenin 22 pika 6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.

Parashtruesja e kërkesës pretendon se: “Shkelja e nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, konsiderojmë se është bërë me rastin e nxjerrjes së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev.nr.295/22 të dt. 27.03.2023, për shkak se duke vërtetuar gabimisht si të drejtë zbatimin e dispozitave materiale ligjore nga organi punëdhënës, parashtrueses së kërkesës përmes këtij aktgjykimi i është mohuar e drejta e garantuar me nenin 22 dhe 49 të Kushtetutës, si dhe i është mohuar e drejta e garantuar me nenin 53 dhe nenin 70 paragrafi 3 të Ligjit të Punës. Po ashtu edhe tej zgjatja e procesit gjyqësor për gati 10 vite konsiston në shkeljen e nenit 6 paragrafi 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.”

31. Parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që të shpallë kërkesën e pranueshme, të konstatojë që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [Rev.nr.295/2022], i datës 27 mars 2023, është në kundërshtim me Kushtetutën dhe ta kthejë në rivendosje.

## **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

#### **Neni 22**

#### **[Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]**

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

[...]

(6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;

[...]

#### **Neni 31**

**[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
  2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
  3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
  4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
  5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
- [...]

**Neni 54**

**[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]**

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

**Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

**Neni 6**

**(E drejta për një proces të rregullt gjyqësor)**

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
- [...]

**LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS**

**Neni 5**

**Ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimit**

1. Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi.
2. Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i personave me aftësi të kufizuara gjatë punësimit, avancimit në punë dhe avancimit profesional, nëse për atë vend pune është i aftë ta kryejë punën në mënyrë adekuate.
3. Nuk konsiderohet diskriminim, çdo dallim përjashtim ose dhënie e përparësisë, përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune, në bazë të kritereve të caktuara që kërkohen për atë vend pune.

4. Punëdhënësi është i obliguar që në rastin e punësimit të punëtorëve, për të njëjtin vend pune të përcaktojë kritere dhe mundësi të barabarta si për femra ashtu edhe për meshkuj.

5. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/3 Kundër Diskriminimit, do të zbatohen drejtpërsëdrejti kur është në pyetje marrëdhënia e punës e lidhur në mes të të punësuarit dhe punëdhënësit.

#### **Neni 69**

##### **Ndërprerja e marrëdhënies së punës nga i punësuarit**

1. I punësuarit ka të drejtën e ndërprerjes së Kontratës së Punës në mënyrë të njëanshme;

2. I punësuarit me kontratë në kohë të caktuar për ndërprerjen e kontratës së punës, duhet ta informojë punëdhënësin paraprakisht në formë të shkruar në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa i punësuarit me kontratë në kohë të pacaktuar në afatin prej tridhjetë (30) ditësh.

[...]

#### **Neni 70**

##### **Ndërprerja e Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit**

1. Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur:

1.1. ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;

[...]

#### **Neni 71**

##### **Koha e njoftimit për ndërprerjen e kontratës së punës**

1. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës në kohë të pacaktuar në bazë të nenit 70, të këtij ligji në këto intervale kohore të njoftimit:

1.1. prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite punësim, tridhjetë (30) ditë kalendarike;

1.2. prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzetepesë (45) ditë kalendarike;

1.3. mbi dhjetë (10) vite punësim, gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike.

[...]

#### **Neni 72**

##### **Procedura para ndërprerjes së Kontratës**

1. Vendimi për të ndërprerë kontratën e punës duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë arsyetimin për ndërprerje.

[...]

#### **Neni 78**

##### **[Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit]**

1. I punësuarit i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura.

2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës.

3. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh.

#### **Neni 79**

##### **[Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë]**

Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.



## Neni 80

### Vendosja gjyqësore lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës

1. Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve: 1.1.

t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shumën të tillë që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit; ose

1.2. nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna.

[...]

## LIGJI Nr. 05/L -021 PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

### KREU I

#### DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Neni 1

#### Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.

[...]

### Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

32. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

#### Neni 113

[Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

34. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”*

35. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ajo konteston kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.nr.295/2022], e 27 shkurtit 2023, të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parasheh neni 49 i Ligjit.
36. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht me nënrregullin (2), të rregullit 34 të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 34  
[Kriteret e pranueshmërisë]

*(2) “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj.”*  
[...]

37. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih, rastin e GJEDNJ-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, Vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, Vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk



paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime "konfuze dhe të paqarta" (shih, rastet e GJEDNJ-së, Kemmache kundër Francës, nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), Juta Mentzen kundër Lituanisë, nr. 71074/01, Vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe Trofimchuk kundër Ukrainës, Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii).

38. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon që akti i kontestuar i ka shkelur të drejtat e saj kushtetuese të garantuara me nenet: 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të KEDNJ-së.
39. Në këtë kontekst, Gjykata do t'i shqyrtojë dhe analizojë këto pretendime, në pajtueshmëri me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, gjykatat e rregullta dhe Gjykata Kushtetuese është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

#### **(i) Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimet për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së**

40. Parashtruesja e kërkesës pretendon se vendimi i punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ishte në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Punës. Sipas saj, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme që miratoi revizionin e punëdhënësit dhe konstatoi ligjshmërinë e largimit nga puna ishte arbitrar.
41. Gjykata vëren se punëdhënësi ndërpreu marrëdhënien e punës me parashtruesen e kërkesës, me arsyetimin se pozita që ajo e mbante u shua si rezultat i ndryshimeve organizative dhe teknologjike.
42. Parashtruesja e kërkesës kishte dorëzuar ankesë në Inspektoratin e Punës me të cilën e kontestonte ligjshmërinë e vendimit për largimin nga puna. Ajo e fitoi rastin në të dy shkallët e Inspektoratit të Punës, që kishin konstatuar se punëdhënësi bëri shkelje ligjore kur e kishte ndërprerë marrëdhënien e punës. Inspektorati i punës arsyetoi se punëdhënësi nuk kishte argumentuar me saktësi se pozita e punës që e mbante parashtruesja e kërkesës ishte shuar, e as nuk kishte bërë përpjekje për ta transferuar në ndonjë pozitë tjetër të punës. Gjithashtu, Inspektorati i Punës konstatoi se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ishte marrë nga një organ jo kompetent brenda punëdhënësit.
43. Pas kësaj parashtruesja dorëzoi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore, me të cilën kërkoi anulimin e vendimit të punëdhënësit për largim nga puna. Ajo arsyetoi se vendimi nuk ishte marrë në përputhje me Ligjin e Punës, për shkak se punëdhënësi nuk e kishte arsyetuar shuarjen e pozitës së saj të punës për shkak të riorganizimit teknologjik e strukturor, e as nuk e kishte paralajmëruar paraprakisht për largimin nga puna.



44. Gjykata vëren se Gjykata Themelore miratoi në tërësi kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës; vendosi për kthimin e saj në vendin e punës dhe akordoi një kompensim financiar në vlerë prej 43.282.33 euro. Gjykata Themelore arsyetoi se punëdhënësi nuk e kishte paralajmëruar parashtruesen e kërkesës për largimin nga puna, siç kërkohet nga neni 71 i Ligjit të Punës dhe as nuk kishte arsyetuar shuarjen e pozitës së saj të punës për shkak të riorganizimit.
45. Pas ankesës së punëdhënësit, Gjykata e Apelit konstatoi që vendimi për largim nga puna ishte i jashtëligjshëm, mirëpo nuk u pajtua me Gjykatën Themelore për kthimin e parashtrueses së kërkesës në vendin e punës dhe kompensimin financiar të caktuar. Sipas arsyetimit të Gjykatës së Apelit, në rastet kur konstatohet që largimi nga puna është i jashtëligjshëm, nuk mund të vendoset për kthimin e të punësuarit në vendin e punës, përveç kur largimi nga puna është diskriminues, ndërkaq kompensimi financiar i akorduar duhej rivlerësuar.
46. Gjykata Supreme, duke vendosur mbi revizionin e punëdhënësit, i anuloi aktgjykimet e dy gjykatave më të ulëta dhe vendosi në favor të punëdhënësit. Sipas Gjykatës Supreme, punëdhënësi kishte vepruar në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës kur kishte ndërprerë marrëdhënien e punës. Në lidhje me paralajmërimin e punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, Gjykata Supreme vlerësoi se punëdhënësi e kishte përmbushur kërkesën ligjore për paralajmërim për faktin se vendimi për largim nga puna ishte marrë më 5 maj 2014, mirëpo kishte hyrë në fuqi më 20 qershor 2014. Ndërkaq, sa i përket arsyeve për largimin nga puna, Gjykata Supreme vlerësoi se punëdhënësi kishte dëshmuar që për shkak të riorganizimit teknologjik dhe organizativ ishin shuar disa pozita të punës, përfshirë atë të parashtrueses së kërkesës.
47. Gjykata rithekson se, në parim, gjykatat e rregullta kanë autoritetin për t'i vlerësuar të gjitha faktet dhe provat e rastit, si dhe të bëjnë interpretimin e dispozitave ligjore. Gjykata ripërsërit që nuk është gjykatë e shkallës së katërt dhe roli i saj në vlerësimin e çështjes, gabimeve të faktit dhe interpretimeve ligjore të gjykatave të rregullta është shumë i kufizuar. Gjykata nuk mund të ndërhyjë në vlerësimet dhe interpretimet e gjykatave të rregullta, përveç në rastet kur vendimet e tyre janë marrë në mënyrë arbitrare dhe shkelin të drejtat kushtetuese të palëve. (shih rastet e GJEDNJ-së, [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim, i 21 janarit 1999, paragrafi 28; [Tommaso kundër Italisë](#), nr. 43395/09, Aktgjykim, i 23 shkurtit 2017, paragrafi 170; [Hasan Tunç dhe të tjerët kundër Turqisë](#), nr. 19074/05, Aktgjykim, i 31 janarit 2017, paragrafi 54-56; rasti i Gjykatës, [KI96/21](#), parashtrues *Xhelal Zherka*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shtatorit 2021, para. 49-51; [KI49/19](#), parashtrues *Limak Kosovo International Airport S.H.A.*, “*Adem Jashari*”, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shtatorit 2019, para. 47-51).
48. Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës kishte mundësinë që gjatë procesit gjyqësor t'i adresonte të gjitha pretendimet dhe argumentet juridike në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtrueses së kërkesës lidhet me rezultatin e procesit gjyqësor dhe vlerësimin e fakteve dhe provave nga gjykatat e rregullta. Parashtruesja e kërkesës nuk përmend ndonjë të metë procedurale që do të mund të ngritë çështje të procesit të rregullt gjyqësor. Gjykata rithekson se roli i saj është shumë i kufizuar për të vlerësuar nëse vendimet e gjykatave të rregullta ishin të drejta në aspektin përmbajtësor, ndryshe do të vepronte si gjykatë e shkallës së katërt. Për më tepër, gjykatat e rregullta nuk morën veprime arbitrare por vepruan në kuadër të juridiksionit të tyre duke i vlerësuar provat dhe interpretuar ligjin.
49. Gjykata konstaton se pretendimi i parashtrueses së kërkesës për interpretimin e gabuar të ligjit dhe të provave, i përket pretendimeve “*të shkallës së katërt*” dhe duhet shpallur si qartazi të pabazuara.



**(ii) Vlerësim i Gjykatës përkitazi me pretendimin për shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas**

50. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon që vendimi për largim nga puna ishte marrë në kohën kur ajo ndodhej në pushimin e lehonisë. Ajo thekson se ky veprim paraqet një akt diskriminues, duke u bazuar në Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas e cila është e përfshirë në Kushtetutë. Për të mbështetur këtë pretendim, ajo ka dorëzuar dokumente shëndetësore që vërtetojnë kohën e lindjes të djalit të saj.
51. Gjykata e ka të qartë pretendimin e parashtrueses së kërkesës, por shterimi i mjeteve juridike përveç detyrimit të shterimit të mjeteve juridike në kuptimin formal-procedural, që nënkupton mundësinë e përdorimit të mjetit juridik kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë, ngërthen në vete edhe detyrimin për shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në “substancë” para gjykatave të rregullta në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, i kanë shfrytëzuar ato në të dy kuptimet (shih, rastet e Gjykatës, [KI71/18](#), parashtrues *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 nëntorit 2018, paragrafi 57; [KI119/17](#), parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 prillit 2019, paragrafi 73; rastin [KI154/17 dhe KI05/18](#), parashtrues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “BARBAS”*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 korrikut 2019, paragrafi 94; dhe rastin [KI163/18](#), parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri i 24 qershorit 2020, paragrafi 61).
52. Në një kontekst të tillë, kur pretendimet e parashtruesit të kërkesës as formalisht por as në substancë/përmbajtje nuk janë ngritur para gjykatave të rregullta, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJENDJ-së, sa i përket kriterit për shterjen e mjeteve juridike në kuptimin substancial dhe rikujton se në rrethana të tilla, pretendimet e tilla nuk mund të shqyrtohen nga gjykata për mungesë të shterimit të mjeteve juridike në kuptim substancial. Bazuar në po të njëjtën praktikë gjyqësore, Gjykata kishte refuzuar shqyrtimin e pretendimeve përkatëse sepse të njëjtat nuk ishin ngritur asnjëherë para gjykatave të rregullta (shih, ndër të tjerash, rastet e Gjykatës [KI119/17](#), me parashtrues *Gentian Rexhepi*, cituar më lart, paragrafi 71; [KI154/17 dhe KI05/18](#), me parashtrues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “BARBAS”*, cituar më lart, paragrafi 92; [KI155/18](#), parashtrues *Benson Buza*, Aktvendim për papranueshmëri i 25 shtatorit 2019; paragrafi 50; [KI163/18](#), me parashtrues *Kujtim Lleshi*, cituar më lart, paragrafi 59; dhe [KI40/20](#), parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 20 janarit 2021, paragrafët 66-69).
53. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, edhe nëse parashtruesi i kërkesës nuk ka përmendur ndonjë nen specifik të Kushtetutës nga Kapitulli II, të paktën ai është dashur të ngritë argumente me efekt të ngjashëm ose të njëjtë bazuar në legjislacionin në fuqi pranë gjykatave të rregullta (shih, në mënyrë të ngjashme rastin e Gjykatës [KI40/20](#), parashtrues *Sadik Gashi*, i cituar më lart, paragrafi 68, dhe rastet e GJEDNJ-së [Gäfgen kundër Gjermanisë](#), cituar më lart, paragrafi 142, 144 dhe 146; [Radomilja dhe të tjerët kundër Kroacisë](#), cituar më lart, paragrafi 117; [Karapanagiotou dhe të tjerët kundër Greqisë](#), nr. 1571/08, Aktgjykim, i 28 tetorit 2010, paragrafi 29).



54. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk e ka ngritur pretendimin për diskriminim në lidhje me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas në asnjë instancë. Në ankesën drejtuar punëdhënësit dhe Inspektoratit të Punës, parashtruesja e kërkesës ngrii pretendime dhe argumente tjera juridike. Edhe në kërkesëpadinë e parashtruar në Gjykatën Themelore parashtruesja e kërkesës nuk ka ngritur çështjen e diskriminimit.
55. Gjykata vëren se ankesën në Gjykatën e Apelit dhe revizionin në Gjykatën Supreme e kishte ngritur punëdhënësi dhe jo parashtruesja e kërkesës. Megjithatë, në përgjigjen ndaj ankesës dhe revizionit të punëdhënësit, parashtruesja e kërkesës ka pasur mundësi të ngrejë çështjen e diskriminimit, mirëpo nuk e kishte përmendur fare.
56. Në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës për herë të parë solli çështjen e diskriminimit në Gjykatë dhe jo më herët te gjykatat e rregullta. Kështu, ajo nuk u ofroi gjykatave të rregullta, përfshirë Gjykatën Supreme, mundësinë të trajtonin pretendimet e saj për diskriminim në lidhje me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas.
57. Gjykata konstaton se pretendimi për diskriminim duhet refuzuar si i papranueshëm për shkak të mos shterimit të mjeteve juridike.

### **(iii) Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimet e tjera**

58. Parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Po ashtu, parashtruesja e kërkesës përmend edhe shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës përkitazi me te zgjatjen e procedurës gjyqësore.
59. Gjykata thekson se nenet e lartcekura parashtruesja e kërkesës vetëm i ka përmendur dhe cituar, duke i ndërlidhë me pretendimin e saj kryesor që ka të bëjë me interpretimin e gabuar të ligjit. Po ashtu, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës thekson edhe te zgjatjen e procedurës gjyqësore mirëpo vetëm e përmend këtë pretendim pa ofruar argumente juridike.
60. Gjykata rithekson se vetëm përmendja dhe citimi i neneve të Kushtetutës apo të KEDNJ-së nuk mjafton për të ngritur pretendime për shkelje të të drejtave kushtetuese. Parashtruesit e kërkesave duhet të paraqesin dëshmi dhe argumente juridike që mbështesin pretendimet e tyre (shih, rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 prillit 2021, paragrafi 81; [KI166/20](#), parashtrues *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 dhjetorit 2020, paragrafi 52; [KI04/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 11 majit 2021, paragrafët 38-39; rastet e GJEDNJ-së, [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, Vendim i 31 majit 2005; [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, Vendim i 25 shtatorit 2008).
61. Bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, një pretendim i ngritur nga parashtruesit e kërkesave përbëhet nga dy elemente: rrethanat faktike dhe argumentimet juridike që i mbështesin ato pretendime. Kërkesat duhet të përmbajnë, ndër të tjera, përshkrimin e fakteve dhe shkeljet e pretenduara, bashkë me argumentet përkatëse. Në të kundërtën, kërkesa refuzohet dhe mund të mos trajtohet nga Gjykata. Nëse kërkesa përmban vetëm fraza të paqarta apo fjalë të “izoluara”, nuk mund të konsiderohet se është ngritur një pretendim (rastet e GJEDNJ-së, [Rustavi 2 Broadcasting Comany LTD dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë](#), nr. 16812/17, Aktgjykim i 18 korrikut 2019, paragrafi 244-246; Ilias dhe Ahmed kundër Hungarisë, nr. 47287/15, Aktgjykim i 21 nëntorit 2019, paragrafi 82-8).

62. Gjykata konstaton se pretendimi i parashtrueses së kërkesës për shkelje të neneve të lartcekura i përket kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, andaj, si të tilla, në baza kushtetuese edhe këto pretendime duhet shpallur qartazi të pabazuara.

### **Përfundime**

63. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se: (I) pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, i përkasin kategorisë së parë (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (II) pretendimet për shkelje të nenit 24 dhe 22 të Kushtetutës, refuzohen për shkak të mos shterimit substancial të mjetit juridik; (III) pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 49, 54, 31 të Kushtetutës, përkritazi me tej zgjatjen e procedurës, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj, si të tillë, në baza kushtetuese edhe këto pretendime në baza kushtetuese shpallen qartazi të pabazuara.

64. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, në pajtueshmëri me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës, duhet deklaruar e papranueshme si qartazi e pabazuar.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 29 prill 2024, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- III. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

**Gjyqtarja raportuese**

Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Gresa Caka-Nimani

